



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 684 / 8 Prot.

Tiranë, më 10 .09. 2018

V E N D I M

Nr. 123, Datë 10.09.2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË GJIROKASTËR
MBI RREGULLSHMËRINË FINANCIARE

**(Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH)*

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi rregullshmërinë financiare në Bashkinë Gjirokastër”, sipas programit të auditimit nr. 684/1 prot., datë 12.06.2018, për veprimtarinë: Për Bashkinë Gjirokastër nga data 01.08.2015 deri më datën 31.12.2017 dhe për 6 ish komunat: Picar, Cepo, Lazarat, Lunxheri, Odrie dhe Antigone, nga data 01.01.2013 deri më datën 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se për subjektet të cilët kanë ndërtuar pa leje janë mbajtur **16 vendime administrative** (me gjobë) në vlerën **3,500,000 lekë**, vlerë e pa kontabilizuar në librat e llogarive të Bashkisë Gjirokastër. Nuk janë ndjekur procedurë ligjore për arkëtimin e gjobave, veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin

dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, nenet 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”, ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VII, faqe 164-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Drejtorin e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Gjirokastrë, të marrë masa për kontabilizimin e gjobave dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e tyre nga 16 subjekte në vlerën **3,500,000 lekë**, për kryerje të punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi. Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur strukturë të menaxhimit të aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në efikasitet të ndërtesave me sipërfaqe totale 9894 m² dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej 1707 ha, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike” *(Më hollësisht trajtuar në pikën VII, faqe 164-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore etj.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar rregullore e arkivës, harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit për ruajtjen e aktiveve, mënyra e bashkëveprimit midis strukturave të ndryshme në rastet kur në një proces pune marrin pjesë disa struktura. Mungojnë rregullat që përcaktojnë frekuencën e raportimit të menaxherve kryesor të titullari, llojet e raporteve për informimin e tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, faqe 22-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të marrë masa për implementimin konkret të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe rritjes profesionale punonjësve nëpërmjet trajnimeve brenda institucionit. Të hartohen rregullave për ruajtjen e aktiveve dhe rregullore e arkivës. Të përcaktohen llojet e raporteve që duhet të përgatiten për titullarin nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e tyre (lloji i raportit javor, mujor, tremujor etj.).

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e buxhetit vjetor në zërin e shpenzimeve, nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura. Në këtë zë ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për këtë zë për vitin 2015, 2016 dhe 2017 janë realizuar respektivisht në masën 61% , 75% dhe 77%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Planifikimi i zërit të shpenzimeve është bërë pa llogaritur detyrimet kreditore, të cilat bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2017 Bashkia Gjirokastrë ka një detyrim ndaj të tretëve prej **6,455,959 lekë** (llogaria 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 27-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave në vitin e mëparshëm buxhetor. Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore (30 ditë), duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin.

4.2. Rekomandim: Titullari dhe Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 6,455,959 lekë. Për këtë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave. Në zbatim të pikës 88 të udhëzimit të mësipërm të bëjë publikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit janë paguar punonjës me kontratë pune provizore, për të cilët është aplikuar ndalesa e tatimit në burim por nuk është aplikuar ndalesa e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7703, date 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Projekt Raportit të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë në rastet e punësimit të punonjësve me kontratë provizore, të kryej deklarinimin e tyre në sistemin tatimor dhe të realizojë pagesën e TAP dhe të sigurimeve shoqërore, në të njëjtën mënyrë si dhe për punonjësit e tjerë me kontratë definitive.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Dokumentimi në magazinë i ndihmave humanitare nga donator të ndryshëm nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Në 2 (dy) raste ku dokumentim është bërë vetëm në sasi, pa vlerë, me fletë hyrjen nr. 17, datë 14.04.2016 për katër kompjuter dhe dy printer nga OSBE për vitin 2016, si dhe fletë hyrjen nr. 20 datë 26.07.2017, tre automjete nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (Kamionçinë TOJOTA, Kamionçinë FORD dhe Autoveturë TOJOTA Land Cruiser), dokumentuar pa vlerë.

Këto veprime janë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 12 pika 3, neni 16 pika 2, neni 23 pika 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe kreu III pika 34,35,36 dhe 37 germa c “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe "marrja në dorëzim e aktiveve" pika 42 dhe 43 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 65-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë, në rastet e marrjes në dorëzim të aktive nga donatorë, apo kur këto aktive transferohen nga institucione të tjera dhe nuk kanë të përcaktuar në dokumentacionin shoqërues vlerën e tyre, nga titullari, bazuar në rregullat në fuqi, të ngrihet komision për përcaktimin e vlerës së tyre dhe mbi bazën e këtij dokumenti të bëhet regjistrimi i vlerës së aktivitetit në kontabilitet.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gjirokastrë është audituar nga KLSH dhe me shkresën nr.766/8 prot. datë 26.12.2015 në Bashkinë Gjirokastrë”, janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes . Nga 35 masa organizative janë zbatuar 22, pa zbatuar 9 masa dhe 4 masa në proces zbatimi. Nga 7 masa për shpërblim dëmi në vlerën 14,071,908 lekë, janë pranuar të gjitha, është bërë njoftimi personave debitorë por nuk janë kryer regjistrimet kontabile. Janë arkëtuar vetëm 96,910 lekë, pa arkëtuar vlera 13,974,988 lekë. Nuk janë bërë kërkesë padi në gjykatë për arkëtimin e detyrimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 11-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, në vlerën totale 1,178,527 lekë. Nga nëpunësi zbatues, bazuar mbi urdhrat e nxjerrë nga titullari të bëhet kontabilizimi i detyrimeve të pa arkëtuara.

Menjëherë

B.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorisë, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **7,158,793¹ lekë**, si më poshtë:

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheshi i Çerçizit - Postbllok”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A. C. & F.” SHPK, me vlerë të kontratës 197,289,293 lekë me TVSH, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **3,471,891 lekë pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5366 prot. datë 30.12.2015, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “A. C. & F.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 127-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

¹ *Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH.*

1.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **3,471,891 lekë** pa TVSH nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A. C. & F.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5366 prot. datë 30.12.2015, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheshi i Çerçizit - Postbllok”, Bashkia Gjirokastrë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Picar Kolonjë, Faza II”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Operatorit Ekonomik “B.” SHPK, me vlerë të kontratës 42,679,942 lekë me TVSH, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,045,350 lekë pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 848 prot. datë 16.02.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Operatorit Ekonomik “B.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 127-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,045,350 pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 848 prot. datë 16.02.2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Picar Kolonjë, faza II”, Bashkia Gjirokastrë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve Gjirokastrë”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Operatorit Ekonomik “B. B.” SHPK, me vlerë të kontratës 58,220,247 lekë me TVSH, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **958,583 pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5355 prot datë 06.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë dhe Operatorit Ekonomik “B. B.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 127-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **958,583 pa TVSH**, nga Operatori Ekonomik “B. B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5355 prot datë 06.09.2016, me objekt “Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve Gjirokastrë”, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: ²

4.1. Rekomandim:

5. Gjetje nga auditimi: ³

5.1. Rekomandim:

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 dhe 2017 në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, nuk janë ndjekur procedurat e duhura ligjore. Për periudhën 2015-2017 pas procesit të vlerësimit, janë nxjerrë aktive jashtë përdorimit, ndërmjet të cilave edhe 8 automjete në vlerën e koston historike 9,181,770 lekë, katër prej të cilave në vitin 2015 me vlerë të koston historike

² dhe ³ *Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH*

2,457,970 lekë dhe katër në vitin 2017 me vlerë të kostos historike 6,723,800 lekë. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2015 në proces verbalin e hartuar ka deklaruar se mjetet e nxjerra jashtë përdorimit janë tjetërsuar dhe janë bërë hyrje në magazinë, por nga auditimi u konstatua se nuk ka dokumentacion që të vërtetojë hyrjen e tyre në magazinë. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2017 ka deklaruar se katër mjetet janë nxjerr jashtë përdorimit nëpërmjet djegies apo dëmtimit, ndërkohë që këto aktive për nga vetë natyra e tyre dhe mbështetur në procedurat që përcakton UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, as nuk digjen dhe as nuk dëmtohen si veprime fundore për të justifikuar nxjerrjen jashtë përdorimit, por pasi vlerësohen se janë të pa përdorshme, inventarizohen si të tilla dhe i nënshtrohen procedurave të shitjes me ankand.

Në të dy rastet nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur procesin dhe nuk ka bërë veprimet e duhura përmbysë, pasi ka hequr përfundimisht nga kontabiliteti aktivet e mësipërme, duke i çregjistruar nga llogaria 215 “Makineri” dhe duke mos bërë regjistrimin e aktiveve, si të pa përdorshme, në llogarinë përkatëse në kontabilitet, duke humbur kështu gjurmën e tyre të auditimit. Në këtë mënyrë për vitin 2015 dhe 2017 pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë saktë vlerën e aktiveve të institucionit.

Pas përfundimit të punës audituese në teren, si dhe pas dërgimit të Projektraportit të auditimit në subjekt, në vlerësim të gjetjeve të kryera nga KLSH, Titullari i institucionit me urdhrin nr. 272, datë 23.08.2018, dorëzuar pranë KLSH, ka ngritur komision të veçantë “Për verifikimin fizik të ekzistencës së mjeteve në pronësi të bashkisë, pavarësisht përfundimit të procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2015 dhe 2017”.

Komisioni i mësipërm në procesverbalin e mbajtur në datën 24.08.2018 (dorëzuar pranë KLSH një kopje), ka konstatuar se janë gjendje vetëm 7 automjete, në gjendjen e tyre të pa tjetërsuar, nga 8 që janë nxjerr jashtë përdorimit për të dy vitet. Komisioni deklaron se mungon mjete “Kamioni Benz me rimorkio, me naftë ngjyrë portokalli”, me vlerë të kostos historike 397,000 lekë. Komisioni ka shoqëruar me foto të mjeteve proces verbalin e mbajtur. Shtatë mjetet e gjetura, janë vlerësuar në skrap dhe janë bërë hyrje në Bashkinë Gjirokastrë në sasinë 6885 kg skrap, në vlerën 162,300 lekë (dorëzuar një kopje e fletëhyrjes në KLSH). Për të përcaktuar çmimin, bashkia i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga komisioni i daljes jashtë përdorimit të aktiveve, në përfundim të këtij procesi, si në vitin 2015 dhe në vitin 2017, nuk janë marrë masa për dorëzimin në magazinë të 8 mjeteve të vlerësuara si jashtë përdorimit, pra të pa përdorshme më si makineri, por si aktive që duhet ti nënshtroheshin një procedure tjetër ligjore për shitje.

Veprimet fiktive të kryera nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2015, për 4 automjete me vlerë totale të kostos historike 2,457,970 lekë, kanë sjellë si pasojë humbjen e gjurmës së auditimit nga ana kontabël (gjë e cila duhet të sistemohet nga institucioni gjatë vitit 2018, pas bërjes hyrje në magazinë në datën 29.08.2018), por këto veprime fiktive nuk kanë sjellë efekte reale mbi humbjen fizike të aktiveve.

Veprimet fiktive të kryera nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2017, për 4 automjete me vlerë totale të kostos historike 6,723,800 lekë, kanë sjellë si pasojë humbjen e gjurmës së auditimit nga ana kontabël për 4 mjete, për 3 prej të cilave (ato të cilat janë konstatuar nga komisioni i vitit 2018, se janë gjendje në Bashki dhe janë bërë hyrje në magazinë në datën 29.08.2018), duhet të kryhen veprimet rregulluese nga institucioni gjatë vitit 2018. Por këto veprime fiktive të kryera nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2017 për mjetin “Kamioni Benz me rimorkio, me naftë ngjyrë portokalli”, me vlerë të kostos historike 397,000 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, kanë sjellë efekte reale mbi humbjen e gjurmës së auditimit nga ana kontabël dhe gjithashtu humbjen fizike të mjetit, pasi

sipas konstatimeve të bërë nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 272, datë 23.08.2018, ky mjet nuk është gjetur në Bashkinë Gjirokastrë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, dhe ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit për vitin 2015 dhe 2017 dhe nëpunësin zbatues për këtë periudhë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 52-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Nga Titullari i institucionit të analizohet situata e vlerësimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre për vitin 2015 dhe 2017 me qëllim marrjen e masave për eliminimin e anomalive të tilla. Të hartohen rregulla të brendshme për procedurën e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit, bazuar në legjislacionin në fuqi. Këto rregulla tu shpërndahen të gjithë punonjësve për njohje. Anëtarët e komisionit të inventarizimit, nxjerrjes jashtë përdorimit etj., përpara kryerjes së detyrës konkrete të trajnohen nga institucioni për njohjen e procedurës që do të kryejnë dhe ky veprim të dokumentohet. Në raste të tjera të nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit ky proces të mbikëqyret me kujdes nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues. Ky i fundit si kontroll pas faktit, të bëjë regjistrimet përmbyllëse në kontabilitet vetëm pasi procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të jetë kryer sipas legjislacionit në fuqi.

6.2. Rekomandim. Për kamionin me rimorkio, nga titullari të nxirret urdhri i zhdëmtimit për vlerën e kostos historike të kamionit, prej **397,000 lekë** për personat përgjegjës të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2017. Të njoftohen organet përkatëse për humbjen e kamionit, me qëllim ç’regjistrimin e mjetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2015, në 3 ish Komunitat: Lunxheri, Picar dhe Odrie, janë kryer shpenzime për dieta ditore (dhe karta telefonie celulare vetëm për ish Komunën Odrie), në vlerën totale **525,740 lekë, dëm ekonomik** për buxhetin e ish njësiteve vendore. Kjo vlerë është përfituar nga nga 2 punonjës të ish Komunës Lunxheri, në vlerën 105,000 lekë, nga 8 punonjës për ish Komunën Picar në vlerën 181,000 lekë, nga 2 punonjës për ish Komunën Odrie në vlerën 239,740 lekë. Shpenzimet e mësipërme janë bërë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë”, pikën 9 dhe 11 *(Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **525,740 lekë**, nga ish punonjësit, sipas listës së lënë nga KLSH në aneksin nr. 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.40 datë 08.06.2015 në vlerën 144,000 lekë nga ish **Komuna Cepo** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “A. G.” Gjirokastrë me objekt “Grumbullim transport mbeturinash”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se sipas faturës nr.37, datë 05.02.2015 për likuidim pjesor të shërbimit për muajin nëntor-dhjetor 2014 rezulton se operatori ekonomik “A. G.”, nuk ka paraqitur bashkëngjitur faturës asnjë dokument tjetër argumentues dhe justifikues prandaj pagesa në vlerën **144,000 lekë**, përbën dëm ekonomik, shkaktuar buxhetit të Ish Komunës Cepo, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Cepo z. D. L. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël S. P., K. R. dhe G. Gj..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastër duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **144,000 lekë** gjithsej, nga: D. L., S. P., K. R. dhe G. Gj. në vlerën 36,000 lekë për secilin person, për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.45 datë 23.06.2015 në vlerën 72,975 lekë nga ish **Komuna Cepo** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “S. G.” Gjirokastër me objekt “rrugë të brendshme Fushë Bardhë”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se sipas faturës së thjeshtë tatimore nr.1, datë 22.06.2015 operatori ekonomik “S. G.”, në faturë nuk ka paraqitur asnjë vend konkret (vend ndodhje rruge) ku janë kryer punimet, nuk ka përcaktuar përmasat (sipërfaqen) në gjerësi dhe gjatësi të rrugës, mungon kontrata e punimeve dhe nuk ka dokument tjetër argumentues dhe justifikues. Për këtë arsye vlera **72,975 lekë, përbën dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të ish Komunës Cepo, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Cepo z. D. L. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. S. P., z. K. R. dhe z. G. Gj..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastër duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **72,975 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Cepo z. D. L. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. S. P., z. K. R. dhe z. G. Gj., në vlerën **18,244 lekë** për secilin person, për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.51 datë 24.06.2015, me vlerë 81,920 lekë, nga ish **Komuna Cepo** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. D.” Gjirokastër, me objekt “riparim dhe lyerje shkolle”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton vetëm fatura së thjeshtë tatimore nr.31, datë 22.06.2015, e operatorit ekonomik “F. D.”, mungon: kontrata e punimeve, situacioni i punimeve, procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve. Në mungesë të dokumenteve vërtetues të mësipërm, pagesa në vlerën **81,920 lekë, përbën dëm ekonomik**, shkaktuar buxhetit të ish Komunës Cepo, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Cepo z. D. L. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. S. P., z. K. R. dhe z. G. Gj.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e

aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **81,920 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Cepo z. D. L. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. S. P., z. K. R. dhe z. G. Gj., në vlerën **20,480 lekë** për secilin person, për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.40 datë 08.06.2015 në vlerën 119,886 lekë nga ish **Komuna Lunxheri** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. P.” Gjirokastrë me objekt “Blerje gazoil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton fatura tatimore nr.159, datë 08.05.2015. Blerja e naftës me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël është e pa argumentuar pasi nevojat për karburant janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor dhe pasqyruar në regjistrin e prokurimeve publike, mungon kontrata e furnizimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të karburantit në sasinë 689 litra naftë dhe nuk ka dokument tjetër argumentues dhe justifikues. PAGESA në vlerën **119,886 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Lunxheri si rezultat i reformës administrative-territoriale, përbën dëm ekonomik, shkaktuar buxhetit të Ish Komunës Lunxheri, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Lunxheri z. I. K., përgjegjësi i financës z. I. D. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. K. B., znj. M. M. dhe z. A. B..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **119,886 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Lunxheri z. I. K., përgjegjësi i financës z. I. D. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. K. B., znj. M. M. dhe z. A. B., në vlerën 23,978 lekë nga secili person për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.106 datë 16.06.2015 në vlerën 21,600 lekë nga ish **Komuna Lunxheri** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. P.” Gjirokastrë me objekt “Mirëmbajtje mjeti”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se sipas faturës tatimore nr.204, datë 08.06.2015 rezulton se mirëmbajtja e mjetit me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël është e pa argumentuar, mungon kontrata e shërbimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimeve të kryera për mjetin dhe nuk ka dokument tjetër argumentues dhe justifikues. Për këto arsye pagesa në vlerën **21,600 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës përbën **dëm ekonomik** ndaj buxhetit të ish Komunës Lunxheri, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Lunxheri z. I. K., përgjegjësi i financës z. I. D. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. K. B., znj. M. M. dhe znj. A. B..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **21,600 lekë** gjithsej nga ish Kryetari i Komunës Lunxheri z. I. K., përgjegjësi i financës z. I. D. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. K. B., znj. M. M. dhe znj. A. B., në vlerën 4,320 lekë nga secili person, për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.59 datë 17.06.2015 në vlerën 26,600 lekë, nga ish **Komuna Picar** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “L. L.” Gjirokastrë me objekt “Blerje kancelari”, me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezultojnë fatura tatimore nr.44, datë 24.04.2015. Blerja e kancelarisë është e pa argumentuar, mungon kontrata e furnizimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të kancelarisë. Për këto mangësi pagesa në vlerën **26,600 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Picar, përbën **dëm ekonomik**, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Picar z. B. Gj., përgjegjësi i financës z. S. M. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. F. F., z. D. T. dhe z. G. S.. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **26,600 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Picar z. B. Gj., përgjegjësi i financës z. S. M. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. F. F., z. D. T. dhe z. G. S..

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.60 datë 17.06.2015 në vlerën 39,960 lekë nga ish **Komuna Picar** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. M.” Gjirokastrë me objekt “blerje kancelari”, me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezultojnë fatura tatimore nr.97, datë 05.05.2015. Blerja e kancelarisë është e pa argumentuar, mungon kontrata e furnizimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit. Për këto mangësi pagesa në vlerën **39,960 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Picar si rezultat i reformës administrative-territoriale, përbën **dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të ish Komunës Picar, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Picar z. B. Gj., përgjegjësi i financës z. S. M. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. F. F., z. D. T. dhe z. G. S..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e

aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **39,960 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Pizar z. B. Gj., përgjegjësi i financës z. S. M. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. F. F., z. D. T. dhe z. G. S., në vlerën 7,992 lekë nga secili person, për pagesën e kryer pa dokumente justifikuese.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.34 datë 12.06.2015 në vlerën 55,785 lekë nga ish **Komuna Odrie** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. P.” Gjirokastrë me objekt “Blerje karburanti gazoil”, me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton fatura tatimore nr.169, datë 05.05.2015. Blerja e karburantit (naftës) është e pa argumentuar, mungon kontrata e furnizimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të karburantit. Për mangësitë e mësipërme pagesa në vlerën **55,785 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Odrie, si rezultat i reformës administrative-territoriale përbën **dëm ekonomik**, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Odrie z. J. Zh., përgjegjësi i financës zj. M. Sh. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. Ll. D., z. V. Zh. dhe z. Dh. B.. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **55,785 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Odrie z. J. Zh., përgjegjësi i financës zj. M. Sh. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël z. Ll. D., z. V. Zh. dhe z. Dh. B., në vlerën 11,157 lekë për secilin person.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.78 datë 17.06.2015 në vlerën 38,643 lekë nga ish **Komuna Antigone** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “F. P.” Gjirokastrë me objekt “Blerje karburanti gazoil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton se sipas faturës tatimore nr.169, datë 05.05.2015 rezulton se blerja e karburantit (naftës) me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël është e pa argumentuar, mungon kontrata e furnizimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të karburantit. Për mangësitë e mësipërme pagesa në vlerën **38,643 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Antigone si rezultat i reformës administrative-territoriale, përbën **dëm ekonomik**, shkaktuar buxhetit të ish Komunës Antigone, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës zj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël zj. A. H. dhe z. M. K. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)).

16.1.Rekomandim: Bashkia Gjirokastër duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **38,643 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës zj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. A. H. dhe z. M. K., në vlerën 9,661 lekë, për secilin person.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.79 datë 22.06.2015 në vlerën 39,100 lekë nga ish **Komuna Antigone** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “J. Ll.” Gjirokastër me objekt “Blerje dhe vendosje pjesë këmbimi” me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton fatura e thjeshtë tatimore nr.29, datë 17.06.2015. Blerja dhe vendosja e pjesëve të këmbimit është e pa argumentuar, mungon kontrata e shërbimit, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesëve të këmbimit dhe riparimeve. Për mangësitë e mësipërme pagesa në vlerën **39,100 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Antigone si rezultat i reformës administrative-territoriale përbën **dëm ekonomik**, shkaktuar buxhetit të ish Komunës Antigone, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës znj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. A. H. dhe z. M. K.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastër duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **39,100 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës znj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. A. H. dhe z. M. K. në vlerën 9,775 lekë, për secilin person.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr.82 datë 29.06.2015 në vlerën 119,760 lekë nga ish **Komuna Antigone** është kryer pagesë për llogari të operatorit ekonomik “A. T.” me objekt “Riparim i argjinaturës së digës të rrugës së varrezave fshati Asim Zeneli”, me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga verifikimi i dokumentacionit të pagesës rezulton fatura tatimore nr.29, datë 17.06.2015. Kryerja e punimeve është e pa argumentuar, kontrata e punimeve datë 15.06.2015 pa datë fillimi dhe mbarimi të punimeve, situacioni pa datë. Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të punimeve datë 17.06.2015, thuhet:....”*punimet kanë filluar në datë 13.06.2015 dhe kanë përfunduar në datë 16.06.2015*”, ose përpara lidhjes së kontratës. Për mangësitë e mësipërme pagesa në vlerën **119,760 lekë**, kryer në mbyllje të aktivitetit ekonomik financiar të ish Komunës Antigone si rezultat i reformës administrative-territoriale përbën **dëm ekonomik**, shkaktuar buxhetit të ish Komunës Antigone, detyrim për arkëtim nga ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës znj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. A. H. dhe z. M. K..

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2 germa ç, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimin APP nr. 5, datë 27.01.2015 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të

auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë” (Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 68-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandim: Bashkia Gjirokastër duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore, të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **119,760 lekë** gjithsej nga: ish Kryetari i Komunës Antigone z. Y. M., përgjegjësi i financës znj. D. K. dhe komisioni i prokurimit me vlerë të vogël znj. A. H. dhe z. M. K., në vlerën 29,940 lekë për secilin person.

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: 1- Nga verifikimi i ditarit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheshi i Çerçizit - Postbllok”, Bashkia Gjirokastër, i cili fillon nga data 01.02.2016, rezulton se deri në datën e përfundimit të afatit kontraktual të punimeve, nuk është punuar për shkak të kushteve atmosferike 36 ditë gjithsej. Nisur nga ky fakt, AK duhet të kishte bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës deri në datën 15 shkurt të vitit 2017. Duke shtuar edhe faktin që deri në këtë datë ka pasur ndërprerje për shkak të kushteve atmosferike edhe 33 ditë të tjera, afati i përfundimit të punimeve duhet të shkonte deri në datën 10.04.2017 dhe jo më 15.06.2017. Në rast se do të ishte bërë argumentimi teknik i mësipërm, AK do të kishte aplikuar penalitete për vonesa në përfundimin e punimeve, në zbatim të nenit 22, pika b e kontratës, në vlerën **156,000 lekë, e cila është e ardhur e munguar** në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër

2- Nga verifikimi i ditarit të punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve Gjirokastër”, Bashkia Gjirokastër, rezulton se deri në datën 19.07.2017, ditë kur duhet të përfundonin punimet, nuk është punuar në 88 ditë pune për shkak të motit jo të përshtatshëm dhe shtyrja e afatit duhet të ishte bërë për 103 ditë kalendarike, pothuajse aq sa është miratuar në amendamentin e parë, nr. 2456/1, datë 18.05.2017. Për periudhën deri në përfundimin e punimeve dt. 13.03.2018, nuk është punuar 71 ditë pune, për shkak të motit jo të përshtatshëm. AK duhet të kishte bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për 83 ditë të tjera kalendarike, ose deri në datën 10.01.2018. Sipas Amendamentit të kontratës nr. 5911/1, datë 16.10.2017, AK e ka bërë shtyrjen e afatit deri në datë 19.03.2018 dhe kontraktori ka përfunduar punimet në 13.03.2018. Në rast se do të ishte bërë argumentimi teknik i mësipërm, AK do të kishte aplikuar penalitete për vonesa në mbarimin e punimeve, në zbatim të 18 të kontratës, pika b, në vlerën $2/1000 \times 62 \text{ ditë} \times 10,001,985 \text{ lekë}$ (58,208,937– 48,206,952 (vlera e situacionit nr. 8) = **1,220,242 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Gjirokastër.

3- Nga verifikimi i objektit, rezultoi gjithashtu se:

- Pusetat elektrike 40x40x40 me kapak RIC 1084+1086, me vlerë totale 185,600 lekë janë të përmasave më të vogla.

Shuma totale prej 185,600 lekë pa tvsh, është shpenzim jo eficient i kryer nga sipërmarrësi i punimeve (Trajtuar më hollësisht në faqet 127 - 145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gjirokastër, të marrë masa që të kërkojë zbatimin me rigorozitet të afatit të përfundimit të punimeve në kontratat e zbatimit dhe të argumentojë teknikisht shtyrjen e mundshme të këtij afati, duke zbatuar penalitetet kontraktuale në rast të mosrespektimit të afatit. Nëpërmjet strukturave të ngritura për monitorimin e kontratave, të mbikëqyret zbatimin e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Trajtimi i mbetjeve urbane vend depozitimi Gerhot 2017 - 2018”, zhvilluar në datën 24.07.2017, me fond limit 2,083,333 lekë, ka marrë pjesë vetëm OE “T.D.” SHPK, me vlerë të ofertës prej **1,954,080 lekë**, shpallur fitues nga KVO, ndërkohë që nuk i plotëson kriteret e veçanta të DST, pasi një automjet transporti e ka deklaruar për të dy tenderat që zhvillohen njëkohësisht në Bashkinë Gjirokastrë. Tenderi duhej të ishte anuluar nga KVO. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 24, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 120-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të analizojë arsyet e kualifikimit të pa drejtë të operatorit ekonomik dhe të nxjerrë përgjegjësitë. Të konsiderojë faktin se operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST dhe kualifikohen, kanë rrisht dhe nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gjirokastrë ka administruar 8 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën **10,085,303 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore**, nga të cilat një rast për “detyrim kontrate” në vlerën 4,017,749 lekë, një rast për “zgjidhje kontrate” në vlerën 3,242,666 lekë, një rast për shpronësim në vlerën 1,065,163 lekë, tre raste për largime të pa drejta nga puna në vlerën 418,296, etj. Nga vlera e mësipërme janë zbatuar (likuiduar) katër vendime në vlerën 1,583,059 lekë, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2018 katër vendime në vlerën 8,502,244 lekë. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Titullar i institucionit të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore në vlerën **10,085,303 lekë**, të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë **për efektin negativ** që këto vendime i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Sektori juridik në rastet e proceseve gjyqësore të ndjek këtë proces në të gjitha shkallët e gjykimit. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari të nxierren përgjegjësitë administrative dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në informacionin e dhenë nga drejtorja e financës së Bashkisë Gjirokastrë, konstatohet se nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), për periudhën 2015-2017, në faturat e energjisë elektrike të ndriçimit rrugor të qytetit, përveç vlerës së energjisë elektrike të konsumuar sipas aparatit matës, për çdo muaj është llogaritur edhe vlera tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, për 78 kontrata në vlerën totale 320,400 lekë, ndërkohë që ndriçimi rrugor i qytetit nuk ka të instaluar aparat televiziv. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 8, shkronja “b” të udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”, ku përcaktohet se ndriçim publik i rrugëve nuk është subjekt i pagesës së tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv.

4.1.Rekomandim: Bashkisë Gjirokastrë, të hartojnë akt-marrëveshje me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), në të cilën të kërkojë heqjen e detyrimeve në vlerën 320,400 lekë për tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv në faturat e ndriçimit publik rrugor, të cilat janë të faturuara pas hyrjes në fuqi të udhëzimit nr.29, datë

18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”. Gjithashtu t’i kërkohet OSHEE që në vazhdim të ndërpresë llogaritjen e tarifës së mësipërme në faturat e e ndriçimit publik rrugor (*Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: ⁴ **Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i Bulevardit 18 shtatori dhe degëzimeve rruga “Rrexhep Qosja” dhe “Gole Gushi”, zhvilluar në datën 02.06.2016, me vlerë të fondit limit 215,731,462 lekë pa TVSH, është shpallur fitues OE “A. K.” SHPK, me vlerë të ofertës 178,795,711 lekë dhe është s’kualifikuar padrejtësisht BOE “M./S. & A.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 168,965,926 lekë pa TVSH, i cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST që lidhen me kualifikimin profesional, aftësinë teknike, gjendjen ekonomike e financiare, kapacitetin ligjor, certifikatat e kërkuara, por nga Autoriteti Kontraktor është s’kualifikuar për paraqitje oferte të pa rregullt. Konkretisht si rezultat i mos vendosjes nga ofertuesi i s’kualifikuar BOE “M./S. & A.” SHPK, të presjes dhjetore në sasinë e ofruar për dy zëra materiale, në zërin “*F.V. tub korogat rixhid brinjëzuar ø 300 mmm, me izolim të dyfishtë (0.8 mm)*”, nga 7.2 ml që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, prej BOE “M./S. & A.” SHPK është shënuar sasia 72 ml, ndërsa në zërin “*F.V. rërë e imët e verdhë për mbushjen e shtyllave tek bazamenti*”, nga 3.1 m³ që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, prej BOE është shënuar sasia 31 m³.

Nga auditimi konstatohet se kemi të bëjmë me gabim shtypi, devijim i vogël, i cili ka sjellë nevojën e kryerjes së korigjimit aritmetike, me një efekt minimal në ofertë prej 236,250 lekë. Nga Autoriteti Kontraktor është bërë padrejtësisht s’kualifikimi i operatorit ekonomik BOE “M./S. & A.” SHPK pa zbatuar këtë element të procedurës ligjore.

Si rezultat i kualifikimit të operatorit ekonomik “A. K.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 178,795,711 lekë dhe s’kualifikimit padrejtësisht të BOE “M./S. & A.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 168,992,176 lekë pa TVSH, është shkaktuar **përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 9,803,535 lekë pa TVSH**, si diferencë midis dy ofertave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 86-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të analizojë rastin konkret të zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Bulevardit 18 shtatori dhe degëzimeve rruga “Rrexhep Qosja” dhe “Gole Gushi”, pas analizës të nxjerrë përgjegjësitë konkrete për përdorimin pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 9,803,535 lekë pa TVSH.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: ⁵ Në tenderin me objekt "Ndërtimi i Tregut Industrial në qytetin e Gjirokastrës”, zhvilluar në datën 13.02.2017 me vlerë të fondit limit 24,965,770 lekë pa TVSH, është shpallur fitues OE “C. R. 2008” SHPK, me vlerë të ofertës 22,385,495 lekë dhe është s’kualifikuar padrejtësisht OE A.“ SHPK, me vlerë të ofertës 19,019,658 lekë pa TVSH, i cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST që lidhen me kualifikimin profesional, aftësinë teknike, gjendjen ekonomike e financiare, kapacitetin ligjor, certifikatat e kërkuara, por nga Autoriteti Kontraktor është s’kualifikuar për paraqitje oferte të pa rregullt. Konkretisht në tre zëra të preventivit janë konstatuar gabime shtypi, në dy prej të cilëve si rezultat i korigjimeve të tyre, ka lindur nevoja e kryerjes së korigjimit aritmetik, me një efekt minimal në ofertë prej

⁴ dhe ⁵ *Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH*

16,210 lekë. Nga Autoriteti Kontraktor është bërë padrejtësisht s'kualifikimi i operatorit ekonomik "A." SHPK, pa zbatuar këtë element të procedurës ligjore.

Si rezultat i kualifikimit të operatorit ekonomik "C. R. 2008" SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 22,385,495 lekë dhe s'kualifikimit padrejtësisht të operatorit ekonomik "A." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 19,019,658 lekë pa TVSH, është shkaktuar **përdorim pa economicitet, efizienz dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 3,365,837 lekë pa TVSH**, si diferencë midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik". (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 86-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të analizojë rastin konkret të zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtimi i Tregut Industrial në qytetin e Gjirokastrës", pas analizës të nxjerrë përgjegjësitë konkrete për përdorimin pa economicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 3,365,837 lekë pa TVSH.

Menjëherë

B.3. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme Drejtorisë së të Ardhurave, në Bashkinë Gjirokastrë, në fund të vitit 2017 janë krijuar debitorë për taksa dhe tarifa vendore për 557 subjekte private në shumën 29,300,717 lekë dhe taksapaguesit familjarë në vlerën 11,600,469 lekë (2555 familje për taksë toke në vlerën 3,655,389 lekë, 1685 familje për taksë ndërtesë në vlerën 1,332,280 lekë dhe 1685 familje për tarifa të vendore në vlerën 6,612,800 lekë). Agjencia e të ardhurave nuk ka ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", nenet 91, të ligjit nr. 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën VI, faqe 149-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Agjencia e të Ardhurave të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëjë njoftim vlerësimet tatimore, për 557 subjekte debitorë në shumën 29,300,717 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

b - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjohë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

1.2. Rekomandim: Agjencia e të Ardhurave të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **11,600,469 lekë**, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me Postë, për:

- Taksë toke, për 2555 familje me vlerë 3,655,389 lekë;
- Taksë ndërtese, për 1685 familje me vlerë 1,332,280 lekë;
- Tarifa vendore, për 1685 familje me vlerë 6,612,800 lekë;

Në vijimësi

2. Gjetjet nga auditimi: Në Bashkinë Gjirokastrë kanë ushtruar aktivitet 17 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën **376,100 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën VI, faqe 149-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Agjencia e të Ardhurave të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 6 subjekteve në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën **376,100 lekë**, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar, sipas pasqyrës Aneks nr. 2.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Sektori i Menaxhimit të Aseteve, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të subjekti A. Sh. për vitin 2015 dhe 5/mujorin e vitit 2016, për objektin e marrë me qira, me sipërfaqe 144 m², **për vlerën 488,000 lekë**, e ardhur e munguar, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën VII, faqe 164-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin nga subjektet A. Sh. të detyrimit në vlerën **488,000 lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunat Odrie, Cepo, Antigone dhe Lunxheri, gjatë vitit 2013, janë lidhur kontrata për dhënie me qira e tokave bujqësore të pandara, për një sipërfaqe prej 83.6 ha, por nga auditimi u konstatua se 22 fermer nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën **1,254,108 lekë**, të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratave dhe nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (*Më hollësisht trajtuar në pikën VII, faqe 164-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bazuar në kontratat e lidhura, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e vlerës **1,254,108 lekë** nga 22 fermerët, të cilët në kundërshtim me kushtet e kontratës nuk kanë kryer pagesën e detyrimeve.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.08.2015 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të

ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **4 punonjësve**, për procedurat e prokurimit si më poshtë:

a- Për 4 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

1. **Z. A. L.**, me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Gjirokastër, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO);

2. **Z. E. L.**, me detyrë përgjegjës i sektorit të urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO);

3. **Z. G. M.**, me detyrë ish specialist për kontrollin në terren të zbatimit të projekteve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO);

4. **Znj. A. Ç.** me detyrë specialiste për arkivën urbanistike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), **për shkeljet e mëposhtme në procedurat e prokurimit publik:**

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b/d/dh, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a/c; neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1/a, 2, 3 dhe 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 “Titullari i Autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar”, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” neni 68 “Raporti Përmbledhës”, të, me pasojë **përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 13,169,372 lekë pa TVSH**⁶, në 2 procedura prokurimi si më poshtë:

- Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i Bulevardit 18 shtatori dhe degëzimeve rrua "Rrexhep Qosja" dhe "Gole Gushi", zhvilluar në datën 02.06.2016, me vlerë të fondit limit 215,731,462 lekë pa TVSH, është shpallur fitues OE "A. K." SHPK, me vlerë të ofertës 178,795,711 lekë dhe është s'kualifikuar padrejtësisht BOE "M./S. & A." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 168,965,926 lekë pa TVSH, i cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST që lidhen me kualifikimin profesional, aftësinë teknike, gjendjen ekonomike e financiare, kapacitetin ligjor, certifikatat e kërkuara, por nga Autoriteti Kontraktor është s'kualifikuar për paraqitje oferte të pa rregullt. Konkretisht si rezultat i mos vendosjes nga ofertuesi i s'kualifikuar BOE "M./S. & A." SHPK, të presjes dhjetore në sasinë e ofruar për dy zëra materiale, në zërin "F.V. tub korogat rixhid brinjëzuar ø 300 mmm, me izolim të dyfishtë (0.8 mm)", nga 7.2 ml që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, prej BOE "M./S. & A." SHPK është shënuar sasia 72 ml, ndërsa në zërin "F.V. rërë e imët e verdhë për mbushjen e shtyllave tek bazamenti", nga 3.1 m³ që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, prej BOE është shënuar sasia 31 m³.

Nga auditimi konstatohet se kemi të bëjmë me gabim shtypi, devijim i vogël, i cili ka sjellë nevojën e kryerjes së korrigjimit aritmetike në vlerën e ofertës dhe njoftimin e operatorit ekonomik për këtë, gjë e cila nuk është kryer nga Autoriteti Kontraktor (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Titullari), por është s'kualifikuar pa realizuar këtë detyrim të procedurës ligjore. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk duhet të kishte bërë s'kualifikimin e BOE "M./S. & A." SHPK. Gjithashtu Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk duhet të kishte miratuar raportin përmbledhës të KVO dhe nuk duhet të kishte bërë shpalljen fitues të OE "A. K." SHPK.

Si rezultat i kualifikimit të operatorit ekonomik "A. K." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 178,795,711 lekë dhe s'kualifikimit padrejtësisht të BOE "M./S. & A." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 168,992,176 lekë pa TVSH, është shkaktuar **përdorim pa ekonomikitet**,

⁶ *Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH*

efiçencë dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 9,803,535 lekë pa TVSH ⁷, si diferencë midis dy ofertave.

- Në tenderin me objekt "Ndërtimi i Tregut Industrial në qytetit e Gjirokastrës", zhvilluar në datën 13.02.2017 me vlerë të fondit limit 24,965,770 lekë pa TVSH, është shpallur fitues OE "C. R. 2008" SHPK, me vlerë të ofertës 22,385,495 lekë dhe është s'kualifikuar padrejtësisht OE A." SHPK, me vlerë të ofertës 19,019,658 lekë pa TVSH, i cili plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST që lidhen me kualifikimin profesional, aftësinë teknike, gjendjen ekonomike e financiare, kapacitetin ligjor, certifikatat e kërkuara, por nga Autoriteti Kontraktor është s'kualifikuar për paraqitje oferte të pa rregullt. Konkretisht në tre zëra të preventivit janë konstatuar gabime shtypi, në dy prej të cilëve si rezultat i korrigjimeve të tyre, ka lindur nevoja e kryerjes së korrigjimit aritmetik, gjë të cilën Autoriteti Kontraktor nuk e ka kryer, konkretisht:

- Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar "Panel metalik IP65 (700 x 550 x 250 mm)", i cili për shkak të gabimeve të shtypit nga operatori A." SHPK ky zë është shkruar "Panel metalik IP65 (100)4550x250mm);

- Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar "Tubo HDPE DN 15 PN 10 Atm" në sasinë prej 35 ml, ndërkohe që nga operatori ekonomik "A." SHPK ky zë është shkruar "Tubo HDPE DN 15 PN 10 Atm" në sasinë prej 37 ml, pra janë ofruar dy njësi më tepër. Çmimi i një njësie në këtë zë në ofertën e operatorit është 105 lekë dhe i gjithë efekti i gamit aritmetik, pas korrigjimit të gabimit të shtypit në ofertë është 210 lekë.

- Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar "Qepen metalik" ne sasinë prej 570 m², ndërkohe që nga operatori ekonomik "A." SHPK zë është shkruar "Qepen metalik" ne sasinë prej 574 m², pra janë ofruar 4 njësi më tepër. Çmimi i një njësie në këtë zë në ofertën e operatorit është 3,500 lekë dhe i gjithë efekti i gamit aritmetik, pas korrigjimit të gabimit të shtypit në ofertë është 14,000 lekë.

Si rezultat i kualifikimit të operatorit ekonomik "C. R. 2008" SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 22,385,495 lekë dhe s'kualifikimit padrejtësisht të operatorit ekonomik "A." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 19,019,658 lekë pa TVSH, është shkaktuar **përdorim pa ekonomikitet, efiçencë dhe efektivitet i fondeve publike në vlerën 3,365,837 lekë pa TVSH ⁸**, si diferencë midis dy ofertave.

C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 3 Kreu II, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Gjirokastrë, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative "Dënimin me gjobë", për 2 mbikëqyrës dhe 2 kolaudatorë punimesh, si më poshtë:**

1. Z. T. S., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikonstruksion i rrugës Sheshi i Çerçizit - Postbllok", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh BOE "A. C. & F." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,726,123 lekë me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Z. E. M., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: Rikonstruksion i rrugës Picar Kolonjë, Faza II", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh

OE "B." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,254,420 me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikonstruksion i rrugës Sheshi i Çerçizit - Postbllok", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh BOE "A. C. & F." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,726,123 lekë me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. Znj. D. Q., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve Gjirokastrë", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh OE "B. B." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,422,383 me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

4. Z. G. S., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: Rikonstruksion i rrugës Picar Kolonjë, Faza II", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh OE "B." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,254,420 me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikualifikim i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve Gjirokastrë", Bashkia Gjirokastrë, me sipërmarrës punimesh OE "B. B." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,422,383 me TVSH si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Gjirokastrë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **për 10⁹ punonjës** si më poshtë:

a- Nga "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet" deri në "Largim nga shërbimi civil", për 7 punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. A. S., me detyrë specialist për transportin, licensat dhe strehimin, në cilësinë e kryetarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2015 dhe 2017, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 109 dhe 111. Për vitin 2015 është bërë dokumentimi në proces verbalin e nxjerrjes jashtë përdorimit se 4 mjete tjetërsohet në skrap dhe bëhen hyrje për tu shitur si mbeturinë hekurishte në magazinë, por sasia e hekurit të dokumentuar në proces verbal nuk është bërë hyrje në magazinë, dhe makinat e dëmtuara nuk janë marrë në dorëzim nga asnjë person në ambiente të tjera të Bashkisë Gjirokastrë. Për vitin 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 mjete, për të cilat në proces verbal nuk është bërë vlerësimi i sasisë dhe vlerës së skrapit dhe nuk është bërë

⁹ Ndryshuar me vendimin nr. 137, datë 27.09.2018 të Kryetarit të KLSH

dorëzimi në magazinë (hyrja), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të shitjes si material mbeturine (skrap).

2. Z. D. S., me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2015 dhe 2017;

3. Znj. M. Ç., me detyrë specialiste buxheti, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017;

4. Z. B. L., me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017;

5. Z. M. B., me detyrë specialist juridik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017;

6. Znj. E. L., me detyrë specialiste për kontrollin në terren të zbatimit të projektit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017;

7. Znj. D. Sh., me detyrë punonjëse protokolli në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017,

për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 109 dhe 111. Për vitin 2015 është bërë dokumentimi në proces verbalin e nxjerrjes jashtë përdorimit se 4 mjete tjetërsohet në skrap dhe bëhen hyrje për tu shitur si mbeturinë hekurishte në magazinë, por sasia e hekurit të dokumentuar në proces verbal nuk është bërë hyrje në magazinë, dhe makinat e dëmtuara nuk janë marrë në dorëzim nga asnjë person në ambiente të tjera të Bashkisë Gjirokastrë. Për vitin 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 mjete, për të cilat në proces verbal nuk është bërë vlerësimi i sasisë dhe vlerës së skrapit dhe nuk është bërë dorëzimi në magazinë (hyrja), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të shitjes si material mbeturine (skrap).

b- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 3¹⁰ punonjësit e mëposhtëm:

1.¹¹

2.¹²

3. Znj. A. K., me detyrë drejtor i zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 93, Ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”. Nuk ka ndjekur procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe nuk ka kryen si duhet regjistrimet kontabel përfundimtare, pas nxjerrjes së aktiveve (4 mjete) jashtë përdorimit.

4. Z. K. B. me detyrë specialist finance, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2015, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 109 dhe 111 në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2015.

5. Z. H. P., me detyrë drejtor i agjencisë së të ardhurave, për shkeljet e mëposhtme :

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos realizuar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore për 392 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, të cilat kryejnë aktivitetet dhe nuk kanë paguar detyrimet tatimore për vlerën 21,932,154 lekë.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 9 të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.08.2015 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 14¹³ punonjësit e mëposhtëm:

a. Nga “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” deri në “ulje në detyrë” për 2¹⁴ punonjës, si më poshtë:

1.¹⁵

2. Z. K. T., me detyrë K/inspektor i IMTV, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2015, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 109 dhe 111, në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2015.

- Për mos zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” përkatësisht nenet 9, 22 dhe 30, me pasojë mos kërkimin në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave në shumën 3,500,000 lekë, ndërsa në 2 raste nuk ka zbatuar vendimet për prishje të objekteve pa leje ndërtimi.

3. Znj. K. R., me detyrë përgjegjëse e sektorit të menaxhimit të aseteve, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, duke mos përgatitur dokumentacionin ligjor për kalimin përfundimtar të aseteve në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë.

c. “Vërejtje”, për 12 punonjësit e mëposhtëm:

1. L. S., me detyrë specialist për inspektimin dhe kontrollin në terren;

2.M. B., me detyrë specialist për inspektimin dhe kontrollin në terren;

3.V. M., me detyrë specialist për inspektimin dhe kontrollin në terren;

4.M. B., me detyrë specialist për inspektimin dhe kontrollin në terren;

5. M. B. me detyrë specialist për inspektimin dhe kontrollin në terren,

për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 40, 41, 89, 90, 91; të ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore” i ndryshuar me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, duke mos ndjekur procedurat e regjistrimit për 17 subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e Bashkisë Gjirokastrë pa qenë të regjistruar në QKR. Si pasojë janë krijuar mungesë të ardhurash në vlerën 376,100 lekë. Për mos hartimin e listës së subjekteve që nuk kanë paguar detyrimet tatimore, dhe mos marrjen e masave shtrënguese për pagesën e këtyre detyrimeve.

6. Z. I. D., aktualisht specialist finance në Bashki, ish përgjegjës i financës në ish Komunën Lunxheri, për mos kryerjen si duhet të kontrollit pas faktit, në kundërshtim me detyrat e nëpunësit zbatues.

7. K. B., aktualisht specialist i pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Gjirokastrë, për parregullsite e konstatuara në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla në ish komunën Lunxheri.

8. Z. D. T., aktualisht me detyrë administrator në Njësinë Administrative Picar, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të komisionit me blerje të vogla në ish Komunën Picar.

9. Z. J. Zh., aktualisht me detyrë administrator në Njësinë Administrative Odrie, ish kryetar i kësaj komunë, për parregullsitë e konstatuara në blerjet me vlera të vogla gjatë aktivitetit të ish komunës.

10. Znj. M. Sh., me detyrë specialiste finance, për parregullsitë e konstatuara gjatë aktivitetit të ish Komunës Odrie, në cilësinë e përgjegjës të financës.

11. Z. E. G., me detyrë policë bashkiak, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla në Bashkinë Gjirokastrë.

12. A. H., me detyrë specialiste protokolli, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të komisionit me blerje të vogla në ish Komunën Antigone.

D.3. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Gjirokastrë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë të mos propozohet masë, si më poshtë:

1. Znj. A. M., me detyrë specialiste e projekteve strategjike.

2. Znj. B. Xh., me detyrë specialiste statistike dhe finance.

3. Znj. L. C., me detyrë magazinierë.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Masat e propozuara do të ishin nga *“Vrejte”*, *“Ulje në detyrë”* deri në *“Largim nga detyra”*.

1. Z. G. M. me detyrë ish specialist për kontrollin në terren të zbatimit të projekteve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.11.2016.

2. Z. Y. M., me detyrë ish kryetar i Komunës Antigone, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2015, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

3. Z. D. M., me detyrë specialist IT, ish punonjës me kontratë të përkohshme, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2015, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

4. Z. E. H., me detyrë ish përgjegjës i arshivës së Bashkisë Gjirokastrë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2015.

5. A. L., me detyrë ish drejtor i zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, në cilësinë e nëpunësit zbatues, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 04.04.2017.

6. Z. D. K., me detyrë ish përgjegjëse e buxhetit, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

7. Z. D. L., me detyrë ish kryetar i komunës Cepo, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

8. **Znj. S. P.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për ish Komunën Cepo, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
9. **K. R.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për ish Komunën Cepo, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
10. **G. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për ish Komunën Cepo, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
11. **Z. I. K.**, me detyrë ish kryetar i komunës Lunxheri, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
12. **Z. B. Gj.**, me detyrë detyrë ish kryetar i Komunës Picar, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
13. **Z. S. M.**, me detyrë ish përgjegjës i financës në ish Komunës Picar, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
14. **Z. G. S.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për ish Komunën Picar, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
15. **Z. Ll. D.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla për ish Komunën Odrie, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
16. **Z. V. Zh.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla në ish Komunën Odrie, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
17. **Z. Dh. B.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla në ish Komunën Odrie, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
18. **Z. M. K.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla në ish Komunën Antigone, ndërprerë marrëdhëniet e punës.
19. **Z. P. S.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla në Bashkinë Gjirokastrë, ndërprerë marrëdhëniet e punës.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore sa më sipër, Bashkia Gjirokastrë, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G. INDICIE PËR KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të kryej trajtimin e detajuar tekniko-juridik të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, **për 7 personat si më poshtë:**

1. **Z. A. S.**, me detyrë specialist për transportin, licensat dhe strehimin, inxhinier mekanik, në cilësinë e kryetarit të komisionit "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve" për vitin 2017;
2. **Z. D. S.**, me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, inxhinier mekanik, në cilësinë e anëtarit të komisionit "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve" për vitin 2015 dhe 2017;
3. **Znj. M. Ç.**, anëtar, me detyrë specialiste buxheti, në cilësinë e anëtarit të komisionit "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve" për vitin 2017;

4. **Z. B. L.**, me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve” për vitin 2017

5. **Z. M. B.**, me detyrë specialist juridik, në cilësinë e anëtarit të komisionit “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve” për vitin 2017

6. **Znj. E. L.**, me detyrë specialiste për kontrollin në terren të zbatimit të projektit, në cilësinë e anëtarit të komisionit “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve” për vitin 2017;

7. **Znj. D. Sh.**, me detyrë punonjëse protokolli, në cilësinë e anëtarit të komisionit “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve” për vitin 2017, për shkeljet e mëposhtme:

b) Në vitin 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 mjete transporti, konkretisht sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlera në lekë e kostos historike
1	Automjet 0079B	copë	1	2495000
2	Automjet Policia 0114B	copë	1	747500
3	Xhip tip Opel me naftë, ngjyrë e bardhe	copë	1	3084300
4	Kamion Benz me rimorkio, me naftë ngjyrë portokalli	copë	1	397000
	Shuma			6,723,800

Në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2017, dokumentuar në proces verbalin e mbajtur në datën 20.12.2017, nga komisioni “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve”, janë kryer veprime fiktive me pasojë humbjen e aktiveve, konkretisht humbjen e një mjeti me vlerë të kostos historike 397,000 lekë.

Proces verbali i mbajtur nga komisioni “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve”, në datën 20.12.2017, është fiktiv, pasi në të përshkruhet se “Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit, grumbulloi të gjitha aktivet për jashtë përdorimit, bëri verifikimin në vend të tyre sipas listës dhe i dogji ose dëmtoi ato sipas rastit”. Edhe në relacionin e hartuar nga kryetari i këtij komisioni z. A. S. përshkruhet e njëjta gjë.

Pas përfundimit të punës audituese në teren, si dhe pas dërgimit të Projektraportit të auditimit në subjekt, në vlerësim të gjetjeve të kryera nga KLSH, Titullari i institucionit me urdhrin nr. 272, datë 23.08.2018, (dorëzuar një kopje pranë KLSH), ka ngritur komision të veçantë “Për verifikimin fizik të ekzistencës së mjeteve në pronësi të bashkisë, pavarësisht përfundimit të procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit në vitin 2015 dhe 2017”.

Komisioni i mësipërm në procesverbalin e mbajtur në datën 24.08.2018 (dorëzuar një kopje pranë KLSH), ka konstatuar se janë gjendje vetëm 3 automjete, në gjendjen e tyre të pa tjetërsuar, nga 4 automjete që janë nxjerr jashtë përdorimit për vitin 2017. Komisioni deklaroi se mungon mjeti “Kamioni Benz me rimorkio, me naftë ngjyrë portokalli”, me vlerë të kostos historike 397,000 lekë. Tre mjetet e gjetura, (së bashku me mjetet e dala jashtë përdorimit në vitin 2015), janë vlerësuar në skrap dhe janë bërë hyrje në Bashkinë Gjirokastrë (dorëzuar një kopje e fletëhyrjes në KLSH). Nga krahasimi i informacionit që përshkruan komisioni i mësipërm në procesverbalin e mbajtur në datën 24.08.2018, me informacionin që përmban proces verbalin e komisionit “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve”, në datën 20.12.2017, rezultojnë prej këtij të fundit veprime fiktive.

Nga komisioni i daljes jashtë përdorimit të aktiveve, në përfundim të këtij procesi nuk janë marrë masa për dorëzimin në magazinë të mjeteve të vlerësuara si jashtë përdorimit, pra të pa përdorshme më si makineri, por si aktive që duhet ti nënshtroheshin një procedure tjetër ligjore për shitje.

Veprime fiktive të kryera nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në vitin 2017 për mjetin “Kamioni Benz me rimorkio, me naftë ngjyrë portokalli”, me vlerë të kostos historike 397,000 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, kanë sjellë efekte reale mbi humbjen e gjurmës së auditimit nga ana kontabël dhe gjithashtu humbjen fizike të mjetit, pasi

sipas konstatimeve të bërë nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 272, datë 23.08.2018, ky mjet nuk është gjetur në Bashkinë Gjirokastrë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin, 109, 110, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit për vitin 2017.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

BUJAR LESKAJ

K R Y E T A R